

Historiku i shkollës sonë dhe programe të ndryshme arsimore që zhvillohen në të



Shkolla fillore nr. 6 e Eleftherios-Kordeliosë gjendet dhe funksionon në anën perëndimore të kompleksit urban të Selanikut. Shkolla funksionoi për here të parë gjatë vitit shkollor 1983/84 si shkollë me 6 mëueses të emëruar. Funksionoi në një godinë të papërshtatshme dykatëshe të marrë me qira (në fund të fotografisë ngjitur) në kushte të këqija me pasoja madje dhe për vet jetën e nxënësve. Kjo gjendje vazhdoi deri në vitin 1997/98 ku, në maj të vitit 1998 u transferua në një godinë të re (fotografia poshtë) bashkë me kopshtin e fëmijëve nr. 6 si dhe me gjimnazin e 3-të.

Gjatë vitit shkollor 1998/99 shkolla u përmirësua dhe u zgjerua ku emëruan edhe gjashtë mësues të tjerë, pra u bë 12-vendësh dhe u riemërtua në shkollë fillore nr. 6 me orar të zgjeruar dhe nga viti shkollor 2002/03 u quajt shkollë fillore ndërkulturore gjithëditore.

Ndryshimi i tij dhe përfitim i profilit ndërkulturor të shkollës (riemërtimi i saj) u bë në kuadër të edukimit ndërkulturor dhe në bazë të Ligjit 2413/96 për përmirësim cilësor të arsimit të ofruar për nxënës me veçanësi arsimore, shoqërore, kulturore dhe edukative, dhe, konkretisht, me vendimin e Ministrit të Arsimit (Gazeta Zyrtare 1143 numri B 29-10-1998).




Gjatë viteve 1998/99 deri në vitin 2003/2004 (me një ndërprerje për vitin 2001/02) dhe 2006-07, 2007/08 (me një ndërprerje për vitin 2004-05 dhe 2005-06) u zbatua dhe zbatohet një program i veçantë i arsimit ndërkulturor në bashkëpunim me QEN (Qendrën e Arsimit Ndërkulturor) e cila është qendër e Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Athinës) dhe IAHEN (Institutit i Arsimit të Homogjenëve dhe të Edukimit Ndërkulturor) nga mësues dygjuhësh dhe jo dygjuhësh (që punësoi dhe emëroi Universiteti në kuadër të programit) për nxënësit e shtetasve të huaj dhe të refugjatëve të rinj, ardhur nga republikat e ish-Bashkimit Sovjetik.

Titulli i programit: «Trajnimi i fëmijëve të riatdhesuar dhe të huaj në shkollë»

Qëllimi i programit ndërkulturor është jo vetëm integrimi shoqëror i nxënësve dhe i familjeve të tyre me respekt në ndryshimi dhe në prejardhje, por edhe kontribimi në formimin e nxënësve të aftë të administrojnë realitetin ndërkulturor dhe të përfitojnë prej tij, patjetër në kuadër të mendimeve dhe praktikave demokratike sociale.

Si mjete për përfitim e qëllimit përdoren:



- Sensibiliteti dhe trajnimi i mësuesve.
- Sensibiliteti dhe informimi i prindërve.
- Solidariteti i shkollës tek emigrantët e rinj, tek të huajt, tek ciganët dhe familjeve të tyre.
- Mundësia e shprehjes shumë-kulturore.
- Ndihma me 6 klasat e mësimit gjithëditor.
- Festat e karakterit ndërkulturor.
- Njohja dhe mbështetja e talenteve dhe mundësive të nxënësve si dhe përforcimi i tyre psikologjik.
- Publikimi i gazetës tremujorshe ndërkulturore të nxënësve të klasës së gjashtë me titull: «Bota në sytë e fëmijëve»
- Faqja speciale e internetit lidhur me edukimin tonë ndërkulturor. Adresa e faqes së internetit: <http://6dim-diap-elefh.thess.sch.gr>
- Libraria e pasur ndërkulturore e shkollës sonë.
- Pjesëmarrja e shkollës në programe të ndryshme evropiane.

Përveç integrimit në shkollën tonë të nxënësve të riatdhesuar dhe të huaj shkolla jonë vitet e fundit kishte dhe programin për integrimin e fëmijëve ciganë. Konkretisht [Universiteti i Janinës](#) (prej vitit 1998 deri në 2004) dhe [Universiteti i Thessalias](#) (2006 – 2008) zbaton programin «**Integrimi i Fëmijëve Ciganë në shkollë**».

Programi i mësipërm zbatohet në nivel të gjithë Greqisë dhe lidhet me një sektor shumë të ndjeshëm të sistemit tonë arsimor, i cili është arrdhja në shkollë dhe integrimi i fëmijëve ciganë në shkollë me qëllim uljen e dështimeve arsimore dhe të përjashtimeve nga shkolla dhe nga shoqëria. Ka një vend organik për një klasë parapregatitore për fëmijët ciganë në shkollë. Gjithashtu shkolla jonë gjatë vitit shkollor 2003-04 ishte dhe **QE.M.P.I.SH (QENDËR E MBËSHTETJES PEDAGOGJIKE E INTEGRIMIT SHKOLLOR)**



Sot, me funksionimin e mijërave shkollave fillore gjithëditore dhe të çerdheve gjithëditore, institucioni i shkollës gjithëditore është zgjeruar në të gjitha zonat e shtetit, që nga qendrat urbane deri në zonat më të largëta dhe të vështira, në mënyrë që të shërbehen mijëra familje. Shkolla gjithëditore ka një përmbajtje të theksuar arsimore dhe sociale. U krijua në mënyrë që të shërbejë objektiva të larta pedagogjike, siç është vlerësimi pedagogjik i kohës së qëndrimit mbasdite të fëmijëve në shkollë, me përgjegjësinë dhe survijimin e mësuesve.



Në kuadër të Shkollës Gjithëditore funksionojnë 6 klasa në shkollën tonë

Programi që ndjekin klasat është si më poshtë:

- Ora e parë: 12.35 klasa A, B
13.15-13.20 pushim
- Ora e 2-të 13.20-14.00 për të gjitha klasat
14.00-14.50 ushqim i lehtë - pushim
- Ora e 3-të 14.50-15.30 për të gjitha klasat
15.30-15.40 pushim
- Ora e 4-të 15.40-16.15 për të gjitha klasat
16.15-largimi i nxënësve



Në programin e shkollës gjithëditore që zbatohet pas orës 12.35 bëhen keto veprime: parapregatitje dhe mësim përforcues në Gjuhë dhe në Matematikë, anglisht dhe veprimtari krijuese. Kur themi veprimtari krijuese nënkuptojmë: Lojëra pedagogjike, lojëra grupore atletike, lojëra me lëvizje muzikore, aktivitete vizatimi: punëdore-ndërtime, teatër dhe lojëra, shfaqje të filmave edukativë dhe argëtues, mësim i kompjuterave në sallën e kompjuterave (12 kompjutera në rrjet).

Në kuadër të **Programit Evropian arsimor Sokratis-Comenius 1** shkolla jonë merrte pjesë në një plan shkollor ndihmese (të një kohëzgjatjeje tre vjeçare nga shtatori i 2003-2006) me 5 shkollat e mëposhtme të Evropës: **Silvesterschule Erle** (shkolla bashkërenduese – institucion në Gjermani) **Remigiusschule Borken** (shkolla partneriale në Gjermani) **Szkola Podstawowa Katy Wroclawskie** (shkolla partneriale në Poloni) **Rigas Herdera Vidusskola** (shkolla partneriale në Letoni) **6/θ Shkolla fillore Atsikopoulou** (shkolla partneriale në Rethimno të Kretës)

Titulli i programit: Fëmijët shkruajnë dhe vizatojnë për fëmijët



Në kuadër të **Programit Evropian Sokratis (Socrates-Comenius) 2.2b**, në të cilin merrnim pjesë vitet shkollore 2006-07 dhe 2007-08 kishim mundësinë të mikprisnim në shkollën tonë, profesorët ndihmës të gjuhës së huaj z. (Christian Kollinger) në vitin 2006-07 dhe Benthe Beckmann në vitin 2007-08 nga Gjermania.

Pjesëmarrja në këtë program ishte vërtet me vlerë.

Përvoja jonë nga bashkëpunimi me profesorët ishte pozitive dhe e mirëfilltë.

Spontaniteti i tyre, dëshira për punë dhe predispozita e tyre miqësore i bënë shumë të dashur në të gjithë pjesëtarët e komunitetit shkollor (nxënës, mësues dhe prindër).

Bashkëpunuan shkëlqyeshëm në të gjithë personelin didaktues të shkollës dhe ishin shumë të dashur tek nxënësit. Na kontaktuan me sistemin arsimor dhe me kulturën e një shteti tjetër, ndërruam idetë tona, praktikat dhe metodat arsimore.



Gjithashtu referojmë se shkolla jona nga viti shkollor 2003/04 merr pjesë në **Programi i Orës Edukative**. Ora edukative e aktiviteteve Krijuese dhe ndërtematike që përbën pjesë të programit javor të paktën të një lkohëzgjatje dyorëshe, ka si synim me metodikën e saj tematike dhe vepruese të përbëjë qëllim të dyfishtë: **e para**, të kompensojë moselasticitetin, një veprimet njëanësore të shkollës dhe **e dyta**, të ujisë me mënyrë të avashtë me parimet dhe me praktikat e saj veprimin e përditshëm didaktik.



Gjithashtu duhet të kujtojmë se në vitet shkollore 1999/00 (nga shkollat e para që Greqisë që filloi programi i Arsimit Olimpik, për arsye të Lojërave Olimpikë të vitit 2004) deri në 2004-05 **programi i Arsimit Olimpik kryhej** nga një mësues fizkulture të veçantë. Gjatë viteve shkollore 2006-07 dhe 2007-08 programi zëvendësohet nga **programi Kallipateira**. Pra në kuadër të programit të ri mësueset e programit përgjegjëse të Gjinnastikës zonja **Vodenioutou Chrisopigi** në vitin 2006-07 dhe zonja **Niftanidou Glykeria** në vitin 2007-08 propozuan projektet cilat u aprovuan për zbatim. Në vitin 2006-07 projekti titullohej **Vendi i Endrrave – Lojra pa Kufi** dhe vitin 2007-08 titullohej: **Mësojmë, duke luajtur për Lojërat Olimpikë**